

UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E KURRIKULËS SË RE TË GJIMNAZIT

Material ndihmës për gjimnazet

Ky dokument synon t'u vijë në ndihmë mësuesve, drejtuesve, prindërve dhe specialistëve të arsimit për zhvillimin e kurrikulës së re, e cila fillon të zbatohet për herë të parë në klasën e dhjetë, në vitin shkollor 2016-2017.

Dokumenti përfshin udhëzime në lidhje me planifikimin e kurrikulës në bazë shkolle, planifikimin e mësimdhënies nga mësuesi dhe vlerësimin e nxënësve, shoqëruar me shembuj dhe modele sugjeruese.

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	3
PLANI MËSIMOR I SHKOLLËS	4
Modele të zgjedhjeve të nxënësve për menaxhimin e kurrikulës me zgjedhje	9
PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES	12
Hyrje.....	12
Llojet e planifikimeve	12
Planifikimi vjetor i lëndës ose i modulit	12
Servantes “Don Kishoti i Mançës” – 5 orë.....	14
Planifikimi sipas periudhave	15
Planifikimi ditor	18
VLERËSIMI I NXËNËSIT	21
Vlerësimi i vazhduar	21
Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse.....	23
Vlerësimi me portofol lëndor	23
Vlerësimi periodik.....	25
Vlerësimi përfundimtar	25
Vlerësimi i nxënësit për zhvillimin e kompetencave kyçe.....	29
SHTOJCË 1: Modulet kurrikulare me zgjedhje të karakterit të përgjithshëm dhe profesional	30
SHTOJCË 2: Formate planifikimi	31
SHTOJCË 3: Modele evidencash	34

PLANIFIKIMI I KURRIKULËS NGA SHKOLLA

PLANI MËSIMOR I SHKOLLËS

Plani mësimor i gjimnazit është hartuar duke u bazuar në:

- prioritetet arsimore për reformën e gjimnazit;
- koherencën me kurrikulën e reformuar të arsimit bazë;
- traditën dhe përvojën pozitive të gjimnazit;
- në studime të IZHA-s lidhur me përvojat më të mira të sistemeve kurrikulare europiane dhe më gjerë;
- respektimin e të drejtës së nxënësit për zgjedhje sipas niveleve, interesave dhe nevojave që ai ka për karrierën e tij (në tregun e punës apo në studimet e arsimit të lartë);
- fleksibilitetin në ofrimin e kurrikulës me zgjedhje nga shkolla;
- lehtësimin e menaxhimit të kurrikulës nga shkolla.

Plani mësimor është një dokument i rëndësishëm, i cili orienton shkollën për organizimin e procesit mësimor, në nivel shkolle dhe klase. Plani përcakton strukturën dhe organizimin e kurrikulës.

PLANI MËSIMOR I GJIMNAZIT

Nr.	Fushat e të nxënit/Lëndët	Shkalla 5		Shkalla 6
		Klasa 10 (orë/javë)	Klasa 11 (orë/javë)	Klasa 12 (orë/javë)
I.	GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	7	7	7
I.1	Gjuhë shqipe	2	2	2
I.2	Letërsi	2	2	2
I.3	Gjuhë e huaj e parë	3	3	3
II.	MATEMATIKË	4	4	4 (B) ose 6 (A+B)
III.	SHKENCAT E NATYRËS	6	6	
III.1	Fizikë	2	2	
III.2	Kimi	2	2	
III.3	Biologji	2	2	
IV.	SHOQËRIA DHE MJEDISI	6	6	
IV.1	Shkenca sociale (Qytetari ¹ , Filozofi ²)	2	2	
IV.2	Histori	2	2	
IV.3	Gjeografi	2	2	
V.	TEKNOLOGJI DHE TIK	2	1	
V.1	TIK	2	1	
VI.	EDUKIMI FIZIK, SPORTE DHE SHËNDETI	3	3	3
Shuma (Kurrikula bërthamë)		28	27	14-16
KURRIKULA ME ZGJEDHJE		2	3	16-14
KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE³		Deri në 2	Deri në 2	Deri në 2
TOTALI (Nr. i orëve javore gjithsej)		30-32	30-32	30-32

¹ Qytetaria zhvillohet në klasën e 10-të.

² Filozofia zhvillohet në klasën e 11-të.

³ Brenda hapësirës së kurrikulës në bazë shkolle zhvillohet dhe shërbimi komunitar. Shërbimi komunitar është i detyruar të kryhet në 18 orë, sugjerohet në klasën e 10-të dhe/ose në klasën e 11-të. Orët e tjera të kurrikulës në bazë shkolle nuk janë të detyruara për nxënësit, ato i mundësojnë shkollës zbatimin e kurrikulës lidhur me projekte ndërkurrikulare, përforcime, veprimtari të tjera shkollore.

KURRIKULA ME ZGJEDHJE

Nr.	Fushat e të nxënit/Lëndët	Shkalla 5		Shkalla 6
		Klasa 10 (orë/javë)	Klasa 11 (orë/javë)	Klasa 12 (orë/javë)
I.	GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	2	2	4
I. 1	Letërsi			2
I. 2	Gjuhë e huaj e dytë	2	2	2
II.	MATEMATIKË			2 (A)
III.	SHKENCAT E NATYRËS			12
III.1	Fizikë			4
III.2	Kimi			4
III.3	Biologji			4
IV.	SHOQËRIA DHE MJEDISI			12
IV.1	Shkenca sociale (Sociologji, Psikologji)			2+2
IV.2	Histori			4
IV.3	Gjeografi			4
IV.4	Ekonomi			2
V.	ARTE⁴ (Teatër, Muzikë, Art pamor)	2	2	2
VI.	TEKNOLOGJI DHE TIK		1	4
VI.1	TIK		1	2
VI.2	Teknologji			2
VII.	EDUKIMI FIZIK, SPORTE DHE SHËNDETI	1	1	1
VIII.	Module kurrikulare	2	2	Max 8⁵

Struktura e kurrikulës

⁴ Fusha e arteve përbëhet nga 3 lëndë, të cilat mund të zhvillohen gjatë 3 viteve të gjimnazit si pjesë e kurrikulës me zgjedhje.

⁵ Modulet kurrikulare mund të jenë module profesionale që zhvillojnë tek nxënësi aftësi të nevojshme për tregun e punës ose module që zhvillojnë tema ndërkurrikulare.

Në këtë plan mësimor, kurrikula është e organizuar në:

- kurrikul bërthamë;
- kurrikul me zgjedhje në bërthamë;
- kurrikul me zgjedhje;

duke e orientuar nxënësin drejt prirjeve dhe interesave të tij.

Kurrikula bërthamë në klasën e 10 dhe 11 është e detyruar dhe e njëjtë për të gjithë; në **klasën e 12**, përveç lëndëve të detyruara dhe të njëjta për të gjithë nxënësit, për lëndën Matematikë nxënësit mund të zgjedhin brenda kurrikulës bërthamë programet sipas niveleve A (ku A është niveli i avancuar) dhe B (ku B është niveli bazë).

Kurrikula me zgjedhje ofrohet në të tria klasat, por ajo vjen duke u rritur në klasën e 12, ku ka një përqindje të konsiderueshme të orëve. Kurrikula me zgjedhje fokusohet në zgjedhjen e lëndëve dhe moduleve profesionale që nuk zhvillohen në bërthamë.

Në kurrikulën me bazë shkolle, shkolla ofron shërbimin komunitar, por mund të ofrojë edhe projekte ndërkurrikulare, përf forcime apo veprimtari të tjera shkollore.

Viti shkollor do të zgjasë 36 javë për klasën 10 dhe 11, ndërsa zgjat 34 javë për klasën e 12.

Java mësimore ka 30-32 orë mësimore. 30 orë në javë shkolla detyrimisht i plotëson me kurrikulën bërthamë dhe kurrikulën me zgjedhje, ndërsa 2 orë të tjera i mundësojnë shkollës zbatimin e kurrikulës në bazë shkolle lidhur me projekte ndërkurrikulare/veprimtari të tjera shkollore. **Nxënësi ka detyrimin të zhvillojë 30 orë në javë për secilin vit shkollor si dhe 18 orët e shërbimit komunitar.** Orët e shërbimit komunitar nxënësi i plotëson në hapësirën e kurrikulës në bazë shkolle. Shërbimi komunitar sugjerohet të kryhet në klasën e 10-të dhe/ose në klasën e 11-të.

Shpjegime për secilën klasë:

- **Klasa 10** ka 28 orë kurrikul bërthamë që zhvillohen në 12 lëndë (Gjuha Shqipe dhe Letërsi llogaritet 2 lëndë), ndërsa kurrikula me zgjedhje ka 2 orë, në të cilën mund të zhvillohen lëndë/module kurrikulare.
- **Klasa 11** ka 27 orë bërthamë, të cilat zhvillohen në 12 lëndë (Gjuha Shqipe dhe Letërsi llogaritet 2 lëndë) dhe 3 orë kurrikul me zgjedhje në të cilën mund të zhvillohen lëndë/module kurrikulare.
- **Klasa 12** ka 14 deri në 16 orë kurrikul bërthamë. Numri i orëve të kurrikulës bërthamë varion sipas zgjedhjeve të programeve A dhe B që bëjnë nxënësit për lëndën Matematikë. Kurrikula me zgjedhje ka 14 -16 orë në të cilat mund të zhvillohen lëndë/module kurrikulare.
- **Shërbimi komunitar** është i detyruar të kryhet në 18 orë. Ai mund të kryhet në klasën e 10 dhe/ose në klasën e 11. **Orët e shërbimit komunitar nxënësi i plotëson në hapësirën e kurrikulës në bazë shkolle.**
- **Modulet kurrikulare** në kurrikulën me zgjedhje mund të kryhen në ato raste kur shkolla ka mundësi që t'i ofrojë dhe në rast se nxënësi ka interes për to. Në rast të kundërt ato mund të plotësohen me lëndë të tjera nga kurrikula me zgjedhje. Modulet kurrikulare mund të jenë 1 ose 2 orë në javë. Në kurrikulën me zgjedhje modulet kurrikulare planifikohen dhe vlerësohen njësoj si lëndët e tjera të planit mësimor.

- Shkolla mund të zgjedhë module nga lista e moduleve kurrikularë dhe profesionale (shtojca 1). Çdo modul tjetër jashtë kësaj liste, i hartuar në bazë shkolle, duhet të miratohet nga DAR-i përkatës.

Modele të zgjedhjeve të nxënësve për menaxhimin e kurrikulës me zgjedhje

KLASA 10

Shembull:

FUSHAT	Zgjedhja Varianti 1	Zgjedhja Varianti 2	Zgjedhja Varianti 3
Gjuhë e huaj e dytë	2 orë		
Arte		Muzikë 2 orë	
Module kurrikulare ⁶			2 orë
TOTALI	2 orë	2 orë	2 orë

Lëndët e fushës së arteve (Art pamor, Muzikë dhe Teatër) ofrohen secila më vete në të tri vitet. Nëse një nxënës zgjedh të studiojë Arte përgjate tre viteve, nxënësi mund të zgjedhë të studiojë vetëm njëerën nga lëndët e fushës së arteve përgjatë një viti shkollor (p.sh. kl.10 - Muzikë), në vitet në vijim ai mund të zgjedhë lëndët e tjera të fushës së arteve (p.sh. klasa 11 - Teatër, klasa 12 - Art pamor).

Nëse shkolla ka disa paralele dhe nëse nxënësit e këtyre paraleleve ose disa prej tyre zgjedhin të studiojnë Arte, klasa të ndryshme mund të bëjnë zgjedhje të ndryshme brenda menuesë së Arteve (p.sh., klasa 10A, 10B, 10C zgjedhin Muzikë, klasa 10 D/E/F zgjedhin Art pamor, kl.10 I/L/M zgjedhin Teatër).

Shembull: Zgjedhja në fushën e arteve e bërë nga i njëjti nxënës gjatë tre viteve

FUSHA E ARTEVE	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12
Art pamor	2 orë		
Muzikë		2 orë	
Teatër			2 orë

⁶ Modulet kurrikulare me zgjedhje të karakterit të përgjithshëm dhe/ose module profesionale.

KLASA 11

Shembull:

FUSHAT	Zgjedhja Varianti 1	Zgjedhja Varianti 2	Zgjedhja Varianti 3	Zgjedhja Varianti 4
Gjuhë e Huaj e dytë	2 orë			
Arte			Dramë 2 orë	
TIK	1 orë			1 orë
Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndeti		1 orë	1 orë	
Module kurrikulare		2 orë		2 orë
TOTALI	3 orë	3 orë	3 orë	3 orë

KLASA 12

Bazuar në interesat e nxënësit, zgjedhjet e lëndëve në klasën e 12-të orientohen duke patur parasysh edhe kriteret e vendosura nga Institucionet e Arsimit të Lartë.

FUSHAT	Zgjedhja Varianti 1 (16 orë kurrikul bërthamë)	Zgjedhja Varianti 2 (14 orë kurrikul bërthamë)	Zgjedhja Varianti 3 (14 orë kurrikul bërthamë)	Zgjedhja Varianti 4 (14 orë kurrikul bërthamë)
Letërsi		2 orë		
Gjuhë e huaj e dytë		2 orë		2 orë
Matematikë				
Shkencat e natyrës (Fizikë, Biologji, Kimi)	- Fizikë (4 orë) - Biologji (4orë) - Kimi (4 orë)		Biologji (4orë)	
Shoqëria dhe mjedisi Shkenca sociale (Histori, Gjeografi, Sociologji. Psikologji		Histori (4 orë) Psikologji (2 orë)	Gjeografi (4 orë) Sociologji (2 orë)	Psikologji (2 orë)

etj.)		Sociologji (2 orë)		
Arte (Teatër, Muzikë, Art Pamor)		Muzikë (2 orë)	Teatër (2 orë)	Art Pamor (2 orë)
Edukim fizik, sporte dhe shëndeti (Sporte)			1 orë	1 orë
Teknologji dhe TIK	TIK (2 orë)		TIK (2 orë)	TIK (2 orë)
Module kurrikulare		2 orë	1 orë	7 orë
TOTALI	14 orë	16 orë	16 orë	16 orë

PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES

Hyrje

Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës, i cili i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe i lirë në procesin e mësimit. Për një planifikim të mirë, mësuesi duhet të njohë mirë:

- Kornizën Kurrikulare
- Kurrikulën bërthamë
- Programin mësuesor

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësuesor. Mësuesi duhet të zbatojë me përpikmëri të gjitha kërkesat e këtij programi. Rezultatet e të nxënësve janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit. Mësuesit përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t'u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit.

Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimit për lëndën ose modulën përfshin:

- Planifikimin vjetor
- Planifikimin për secilën periudhë (Shtator-Dhjetor; Janar-Mars; Prill-Qershor)
- Planifikimin ditor

Në fillim të vitit shkollor mësuesi duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës *planin vjetor* të lëndës ose të modulit, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator- dhjetor). Planin e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësuesor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar te arritjet e kompetencave kyçe dhe të fushës/ lëndës.

Më poshtë janë dhënë sqarime rreth planeve të mësimit, për të cilat IZHA ka hartuar disa formate *sugjeruese*.

Planifikimi vjetor i lëndës ose i modulit

Për planifikimin vjetor të lëndës ose të modulit, mësuesi, përveç programit mësuesor duhet edhe të njohë edhe tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësimit, kurse teksti mësuesor i përzgjedhur është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e

mjaftueshëm përvetësimin të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni.

Plani vjetor është një plan sintetik. Mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tre periudha. Periudhat janë:

- periudha e parë: Shtator- Dhjetor;
- periudha e dytë: Janar – Mars;
- periudha e tretë: Prill- Qershor.

Formati i planit mësimor vjetor përmban këto rubrika:

TEMATIKAT	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES LËNDORE		
	SHTATOR – DHJETOR	JANAR – MARS	PRILL – QERSHOR

- **Tematika:** Në këtë kolonë, renditen tematikat e programit.
- **Shpërndarja e përmbajtjes kryesore së lëndës sipas tri periudhave:**

Në këtë kolonë vendosen përmbajtja kryesore e lëndës që do të zhvillohet në secilën periudhë dhe për secilën tematikë. Gjithashtu, vendoset edhe totali i orëve për secilën periudhë, ku përfshihet njohuri, projekte, përsëritje, punë laborator, biseda letrare, teste etj., në varësi të specifikave të lëndës.

Shembull: Letërsia, klasa X

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes lëndore sipas periudhave		
	Shtator – dhjetor 27 orë	Janar–mars 23 orë	Prill–qershor 22 orë
Teoria e letërsisë	Funksioni dhe vlera e letërsisë. Shkenca për letërsinë. Lidhja e letërsisë me artet e tjera. Ndarja letërsisë sipas gjinive dhe tiparet e tyre. Fabula dhe subjekti. Tema dhe motivet. (6 orë)		
Folklori	Tiparet dhe vlerat e folklorit. Llojet e krijimtarisë gojore. Vlerat e lirikës popullore. Epika popullore, nëndarjet, vlerat e saj. Cikli i Kreshnikëve (6 orë) .		
Antikiteti	Vështrim i përgjithshëm për letërsinë antike. Lindja dhe lulëzimi i epikës, lirikës dhe dramatikës. Karakteristikat e secilës gjini letrare. Përfaqësuesit dhe veprat e tyre kryesore. Homeri “Iliada”, Eskili “Prometeu i mbërthyer”. <i>1 orë test përmbledhës</i> <i>2 orë nga projekti, i cili zgjat përgjatë gjithë vitit, në 5 orë mësimi.</i> Gjithsej 15 orë	Euripidi “Medea” -5 orë.	
Letërsia e Rilindjes		Vështrim i përgjithshëm rreth zhvillimit të Humanizmit dhe të Rilindjes Evropiane si lëvizje e rëndësishme kulturore, letrare dhe artistike. Filozofia dhe zhvillimi i saj. Përfaqësuesit kryesorë në Evropë. Aligeri “Ferri” nga “Komedia hyjnore”	Servantes “Don Kishoti i Mançës” – 5 orë Shekspir “Hamleti”- 5 orë

		7 orë	
Letërsia e vjetër shqipe		Barleti “Histori e Skënderbeut” – 5 orë 1 orë test përmbledhës, <i>2 orë projekt</i> <i>2 orë bisedë letrare</i> Gjithsej 10 orë	Bogdani “Këngët e sibilave” dhe disa poezi të Budit 3 orë
Klasicizmi			Vështrim i përgjithshëm. Tiparet dhe parimet estetike. Përfaqësuesit kryesorë. Elemente të klasicizmit në letërsinë shqipe Molier “Mizantropi” – 6 orë <i>1 orë test përmbledhës</i> <i>1 orë projekt</i> Gjithsej 9 orë

Planifikimi sipas periudhave

Planifikimi i periudhës është një planifikim më afatshkurtër dhe më i detajuar i mësimdhënies. Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi të përcaktojë me kujdes përmbajtjet mësimore që do të zhvillojë gjatë kësaj periudhe, orët mësimore brenda të cilave ato do të realizohen, duke planifikuar paraprakisht situatat e të nxënit përmes të cilave do të mundësohet zhvillimi i kompetencave, burimet e të nxënit, metodologjitë e mësimdhënies si dhe llojet e vlerësimit dhe instrumentet vlerësues.

Plani i një periudhe është analitik dhe në të detajohen temat mësimore që do të zhvillohen përgjatë saj. Mësuesi harton planin e periudhës përkatëse në fillim të saj dhe e dorëzon në drejtorinë e shkollës para fillimit të periudhës. Ky plan hartohet duke iu përmbajtur programit dhe tekstit mësimor përkatës.

Në planet sipas periudhave planifikohen të gjitha orët. Mësuesit janë të lirë të bëjnë ndryshimet e tyre hap pas hapi në varësi të specifikave të lëndës së tyre.

Formati i planit të një periudhe

Formati i planit të një periudhe përmban këto rubrika:

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe (a)						
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës (b)						
Nr. (c)	Tematika / kapitulli (d)	Temat mësimore (e)	Situata e parashikuara e të nxënit (f)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve (g)	Vlerësimi (h)	Burimet (i)
...	P.sh. Diskutim, Stuhi mendimi Punë grup Punë në dyshe Etj.	P.sh., Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup. Vlerësim mes nxënësish	P.sh., Teksti i nxënësit, vepra Teksti i nxënësit, harta e Shqipërisë ose harta e Ballkanit
...			
<i>Shembull (Letërsia)</i> ...	Letërsia antike	P.sh., Eskili “Prometeu i mbërthyer”	P.sh., Altruizmi në ditët tona			
<i>Shembull (Matematika)</i>	Gjeometria në plan	Matja e gjatësive dhe këndeve (Aftësi)	<i>Largesa në hartën e Shqipërisë ose të Ballkanit</i>			

a) Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Në këtë rubrikë mësuesi do të vendosë rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit përgjatë temave mësimore, të zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate në programin mësimor, te rubrika “Rezultatet kryesore të të nxënit, sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së ...”.

b) Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/ lëndës

Në këtë rubrikë vendosen rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate të nxënit nga programi mësimor. P.sh., *në lëndën e letërsisë, gjatë periudhës së parë studiohet krijimtaria folklorike dhe letërsia antike greke. Mësuesi përzgjedh këto rezultate të nxënit:*

- *analizon tiparet kryesore të folklorit tonë, përshkruan origjinën dhe përmbajtjen e eposit kombëtar dhe vlerëson rëndësinë historike dhe kulturore të tij;*
- *analizon tiparet kryesore të letërsisë antike greke dhe romake, përcakton gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe analizon veprat e autorëve përfaqësues të kësaj periudhe.*

c) Numri rendor

Këtu vendosen numrat për temat mësimore. Totali i numrave në planin e periudhës përkon me numrin e orëve që janë përcaktuar në planin vjetor të lëndës ose të modulit.

d) Tematika/Kapitulli

Në këtë rubrikë shënohen tematikat mbi të cilat është ndërtuar programi i lëndës. P.sh., shënohet tematika “Morfologji” në lëndën Gjuhë shqipe; tematika “Ndërvarësia njerëz/vende/rajone/mjedise” në lëndën Gjeografi; tematika “Sistemet” në lëndën Biologji, kapitulli “Veprimet me numra” në lëndën Matematikë etj.

e) Tema mësimore

Në këtë rubrikë shënohen të gjitha temat mësimore që do të zhvillohen gjatë periudhës. Mësuesi, përveç temave që i korespondojnë tekstit mësimor, planifikon edhe orë projekti kurrikular numri i të cilave varet nga specifika të lëndës, orë për testin/detyrën përmbledhëse, orë të tjera për përmbledhje, punë me shkrim, kuize etj., si dhe sugjerohet të planifikohen orë për diskutimin dhe vlerësimin e portofolit në varësi të hapësirës që ka secila lëndë.

f) Situata e të nxënit

Në këtë rubrikë vendosen situatat e të nxënit që mësuesi parashikon të realizojë gjatë periudhës, të cilat mund të ndryshohen dhe plotësohen përgjatë zhvillimit të lëndës. Situatat e të nxënit mund t’i përkasin një teme mësimore, disa temave mësimore, ashtu sikurse mund të ketë tema mësimore për të cilat mësuesi nuk zhvillon situata të nxëni. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale.

g) Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Në këtë rubrikë mësuesi vendos teknikat dhe metodat e mësimdhënies (p.sh., harta e konceptit, parashikimi me terma paraprakë, grupet e ekspertëve, punë në grup etj.) që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar (jo shumë e detajuar sepse e tillë kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor).

h) Vlerësimi

Këtu vendosen teknikat e vlerësimit që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar si p.sh., vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; portofol, prezantim ose punë me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular etj. Kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor.

i) Burimet

Në këtë rubrikë mësuesi vendos burimet që do të përdoren për arritjen e rezultateve të të nxënit si p.sh., teksti i nxënësit, libri digjital, teksti i ushtrimeve (nëse ka të tillë), vepra të ndryshme etj. Kjo rubrikë nuk plotësohet në mënyrë shumë të detajuar, pasi e tillë do të plotësohet në planin ditor.

Planifikimi ditor

Mësuesi planifikon çdo orë mësimore dhe e hedh këtë në planin e tij ditor. Në përgatitjen e një plani ditor mësuesi duhet të përcaktojë rezultatet e pritshme të asaj ore mësimi, të përgatisë veprimtaritë mësimore, të përzgjedhë metodat dhe strategjitë, të përzgjedhë burimet e të nxënit, të përcaktojë teknikat e vlerësimit të përshtatshme për klasën, të parashikojë punën me klasën, grupet, nxënës të veçantë, të parashikojë lidhjen me lëndët e tjera etj.

Formati i planit ditor

Më poshtë jepet formati i sugjeruar i një plani ditor:

Fusha:	Lënda:	Shkalla:V	Klasa:X
Tema mësimore:		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi: -		Fjalët kyçe:	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Vlerësimi:			
Detyra:			

- Fusha (përcaktohet fusha e të nxënit ku bën pjesë lënda)
- Lënda (shënohet emri lëndës)
- Shkalla (shënohet shkalla duke iu referuar Kornizës Kurrikulare)
- Klasa (shënohet klasa)
- Tema mësimore (shënohet tema mësimore)
- Situata e të nxënit (këtu shkruhet shkurtimisht tema e situatës së të nxënit), nëse mësuesi ka planifikuar një situatë. Nëse mësuesi nuk planifikon situatë për atë temë mësimi, nuk do të shkruajë asgjë në këtë rubrikë.
- Rezultatet e të nxënit (këtu vendosen rezultatet e temës mësimore që nxënësi do të arrijë gjatë orës së mësimi).
- Fjalët ose konceptet kyçe të temës mësimore.
- Burimet që do të përdoren gjatë orës së mësimi.
- Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare, nëse ka.
- Metodologjia ose veprimtarinë e nxënësve (metodologjia për arritjen e rezultateve të të nxënit të orës së mësimi dhe veprimtaritë e nxënësve lidhen me situatën e të nxënit, nëse është planifikuar një e tillë).
- Vlerësimi (shënohen teknikat e vlerësimit).
- Detyrat e shtëpisë (shënohen detyrat e shtëpisë, nëse do të jepen).

Shembull 1: Anglisht, klasa X

Field: Languages and communication	Subject: English	Stage: V	Class: X
Topic: The Passive Form		Learning situation: Fairtrade	
Learning outcomes: <ul style="list-style-type: none"> Identify passive forms in a reading text Use passive forms correctly to talk about Fairtrade 		Key words: farmers; consumers; environment; fairtrade; passive form	
Resources: student book; internet; newspaper articles		Cross curricular links: society and environment	
Methodology and activities			
<p>The lesson introduces The Passive Form which is sometimes difficult for students to use. So it is important to present it through familiar or interesting topics thus creating a learning situation. The Passive is used when it isn't important to know (or we do not know) who performed the action. Passive verbs have the same tenses as active verbs.</p> <ol style="list-style-type: none"> Brainstorming: students brainstorm on the definition of "Fairtrade". Teacher helps with new vocabulary and final definition. Pair work: students discuss the questions about shopping (who does the shopping in your family/ What food products do you buy every week? Which of these things are important when you buy food? a. the quality b. where it is produced c. how it is produced d. a fair price?) Discussion: students read an article about Fairtrade and then discuss why "Fair trade" is good for farmers, consumers and the environment. Presenting grammar: elicit from students and then explain the form and uses of passive form. Students identify and underline the passive forms in the article. Exercises: students do the exercises on the student and work books about the passive forms. Role play: time permitted students create and act dialogues or interviewees with farmers using passive forms. 			
Assessment: gap filling exercises; error correction exercises.			
Assignment: Write questions about the article "Fairtrade" using passive forms (When was Fairtrade formed? Where have farming organisations been set up?)			

Shembull 2: Matematikë, klasa X

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: V	Klasa: X
Tema mësimore: Matja e gjatësive dhe këndeve		Situata e të nxënit: Largesia e qyteteve në hartën e Shqipërisë	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore: Nxënësi në fund të orës së mësim: <ul style="list-style-type: none"> - mat me saktësi segmentet dhe këndet; - skicon duke zbatuar një shkallë dhe një kurs (drejtim) të dhënë; - vlerëson dhe interpreton gjatësitë në situata nga jeta reale. 		Fjalët kyçe: largesë, matje e gjatësisë, shkallë, hartë, kursi (drejtim)	
Burimet: Teksti i nxënësit, harta e Shqipërisë, harta e Ballkanit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjeografia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësim: Parashikimi i njohurive: Nxënësi njeh figura të përbëra të krijuara nga figura të ndryshme gjeometrike. Nxënësit punojnë në dyshe. Të dy nxënësit përsërisin së bashku kuptimin e termit “Kurs (drejtim)”. Nxënësi 1 përcakton në hartën e Shqipërisë dy qytete psh. Elbasan dhe Fier. Nxënësi 2 mat me saktësi gjatësinë në hartë të këtyre dy qyteteve. Nxënësi 1 gjen gjatësinë reale duke ditur shkallën e hartës. Të dy së bashku përcaktojnë kursin (drejtimin). Disa prej çifteve prezantojnë rezultatet e punës së tyre. Ndërtimi i njohurive: Dyshet e nxënësve vijnë në të njëjtën mënyrë punën për të llogaritur gjatësi ndërmjet qyteteve të tjera në hartën e Shqipërisë duke këmbyer punën me njëri tjetrin. Disa prej tyre prezantojnë përsëri rezultate duke arsyetuar përgjigjet e tyre. Dyshet e nxënësve vazhdojnë punën me skicimin e fushës së tenisit në formë drejtkëndore. Ata gjejnë përmasat reale të fushës së skicuar. Duke ndjekur shembullin ata skicojnë fushën basketbollit, volejbollit dhe futbollit. Dyshet zgjedhin sipas dëshirës çfarë skicimi do të kryejnë. Disa prej dysheve zgjedhin edhe skicimin e një apartamenti, përmasat e të cilit ata i përcaktojnë sipas dëshirës. Më pas mësuesi/ja pyet nxënësit nëse i njohin vendet e gadishullit Ballkanik dhe cilat janë kryeqytetet e tyre. Ajo kërkon që ata të vlerësojnë me afërsi sa larg mund të jenë këto kryeqytete nga njëra – tjetra. Nxënësi 1 piketon në hartën e Ballkanit dy kryeqytete dhe vlerëson me afërsi largesën ndërmjet tyre. Ai i kërkon shokut të gjej me saktësi largesën e këtyre qyteteve. Ata më pas diskutojnë nëse rezultatet e të dyve për afrohen me njëra- tjetrën. Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre duke arsyetuar përgjigjet.			
Vlerësimi: Mësuesi/ja përdor teknikën e vlerësimit të nxënësit nga nxënësi. Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve lidhur me saktësinë e veprimeve, zbulimin dhe argumentimin e përgjigjeve që lidhen me matjet e sakta apo përafrimi i tyre si dhe për zgjidhjen e situatave nga jeta praktike.			
Detyra: Mësuesi/ja orienton nxënësit për plotësimin e skicimit të liqenit të Shkodrës duke llogaritur përmasat në hartë dhe përmasat reale.			

VLERËSIMI I NXËNËSIT

Vlerësimi i nxënësve është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencat. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënësve, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësve (njohuri, shkathtësi, qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve.

Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshëm për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve, në funksion të mbështetjes së të nxënësve dhe mësimdhënies.

Paketa e dokumenteve për vlerësimin përfshin:

- Kornizën e vlerësimit të nxënësve për arsimin parauniversitar (MAS, Nr. 5563, dt. 23.07.2015)
- Udhëzimin e MAS për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë, Nr.14, dt.28.07.2016
- Nivelet e arritjeve të nxënësve për vlerësimin e kompetencave, shkalla 5 (kl.10-11)
- Portofolin e të nxënësve: Udhëzues për mësuesit në arsimin parauniversitar (2016)
- Formatet sugjeruese të evidencave për vlerësimin e vazhduar.

Vlerësimi për të nxënë i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- Vlerësimin të vazhduar;
- Vlerësimin me test/detyrë përmbledhëse;
- Vlerësimin të portofolit lëndor të nxënësve.

Vlerësimi i vazhduar

- Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi *përgjigjet me gojë ose me shkrim, kuizet, punët në grup, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësve, vlerësimin e nxënësve nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës, përgjatë një periudhe.*
- Për vlerësimin e vazhduar të arritjes së rezultateve të të nxënësve, mësuesi **mban shënime në evidencë për çdo nxënësi**. Shënimet në evidencë mund të mbahen me **notë, simbole** etj., të shoqëruara me **komente** të cilat i referohen niveleve të arritjes së kompetencave lëndore.
- Për lehtësimin e punës së tij mësuesit i sugjerohet të shkruajë në fund të evidencës **një legjendë** e cila shpjegon kuptimin e simboleve të vendosura.
- Komentet i referohen **niveleve të arritjes së kompetencave lëndore** bazuar në dokumentin përkatës të “Niveleve të arritjes” shkalla V (klasa 10 -11).
- Në shtojcë sugjerohen **dy formate të evidencave** për mbajtjen e shënimeve. Mësuesi është i lirë të përshtasë formatin e evidencës, në varësi të specifikave të lëndës, ose të krijojë një formë tjetër të mbajtjes së shënimeve, duke ruajtur pjesën përmbajtësore të saj.

- **Evidenca** dorëzohet në drejtori në përfundim të periudhës dhe ruhet deri në përfundim të vitit shkollor.

Më poshtë jepen disa shembuj për një nxënës të vlerësuar në lëndët:

Shembull 1: Matematikë

Periudha: Shtator – Dhjetor

Nr.	Nxënësi / Data	28.09	14.10	31.10	9.11	25.11	19.12	Komentet janë: Nivelet e arritjes për njohurinë/konceptin përkatës
1	Dritan Kurti	+-						N3 Fuqitë me eksponentë numër negativë
			✓					N3 Kongrunca e trekëndëshave (rasti i 3)
				9				TN
						+		N4 Ndërtimi i diagramës sipas disa të dhënave
							9	N4 Fuqitë me eksponentë numër thyesor
								10

Legjendë: ++ (sh. mire); + (mire); +- dhe ✓ (mesatar); -+ dhe ? (nën mesatar); - dobët; - - (sh. dobët). N1- Niveli 1; N2 – Niveli 2; N3 – Niveli 3; N4 – Niveli 4. TN – test i ndërmjetëm

Në përfundim të periudhës tremujore, vlerësimi i vazhduar mbyllet me një notë përmbljedhëse (NVv). Nota e vlerësimit të vazhduar në këtë rast gjykohet në bazë të ecurisë (progresit ose regresit) të arritjeve të nxënësit përgjatë periudhës, pra NVv është 9. Në shembullin e mësipërm ecuria e nxënësit është progresive, por mund të jetë edhe regressive.

Shembull 2: Fizikë

Periudha: Shtator - Dhjetor

Shënim: Shembulli i mëposhtëm në lëndën e fizikës është vetëm një ilustrim i modelit të plotësimit të evidencës. Mësuesi është i lirë në përcaktimin e numrit të vlerësimeve të një nxënësi përgjatë periudhës

Nr.	Nxënësi / Data	26.09	20.10	31.10	7.11	25.12	19.12	KOMENTE	
1	7						N3 Zbritja e vektorëve	
			6					N2 Interpretimi i grafikut $a=f(t)$	
				+				N3 (Dallimi i peshës me masën)	
					8			TN(Test i ndërmjetëm)	
							+		N3 Inertësia (-)
								8	N3 Pesha e trupit që lëviz me nxitim

Nota e vlerësimit të vazhdueshëm përmes një shembulli në lëndën e fizikës:

- Ky është një model- evidence që paraqet notat e një nxënësi në klasën e dhjetë, në lëndën e fizikës, e cila zhvillohet dy herë në javë, sipas orarit mësimor.
- Hapësira prej 6 rreshtash, që është lënë për secilin nxënë, tregon numrin e vlerësimeve që mësuesi mund të hedhë në evidencë gjatë periudhës së parë, respektivisht duke u bazuar në numrin e orëve mësimore që ka në lëndën e tij.
- Mësuesi është i lirë në përcaktimin e numrit të vlerësimeve të një nxënësi përgjatë periudhës.
- Nxënësi gjatë periudhës së parë ka marrë 4 vlerësime me notë dhe dy me simbole, respektivisht notat 7, 6, +, 8, +, 8, të shënuara në evidencat e mësuesit. Mbi bazën e këtyre 6 vlerësimeve, mësuesi vendos nxënësit notën 8, në rubrikën e NVv. **Kjo notë nuk është mesatare aritmetike e 6 vlerësimeve, por vendoset mbi bazën e gjyqimit progresiv për nxënësin.**

Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse

- Në përfundim të periudhës kryhet vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse, e cila ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni.
- Mësuesi përzgjedh të zhvillojë test ose detyrë përmbledhëse, në varësi të veçorive të lëndës.
- Testi përmbledhës është test që përmban vetëm rezultatet e të nxënit (njohuritë dhe shkathtësitë) kryesore të periudhës përkatëse. Koha e realizimit të testit është 45 min si të gjitha testet e tjera.
- Në përfundim të periudhës, për të lehtësuar nxënësit, drejtorja e shkollës organizon punën që të kryejë shpërndarjen e zhvillimit të testeve ose detyrave përmbledhëse në ditë të ndryshme.
- Nëse drejtorja ka planifikuar të realizojë teste në lëndë të caktuara mund t'i zhvillojë ato në përputhje me testet ose detyrat përmbledhëse.

Vlerësimi me portofol lëndor

- Portofoli është koleksionim sistematik i detyrave dhe punimeve të kryera nga nxënësi përgjatë periudhës për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve).
- Mësuesi udhëzon nxënësit për krijimin e portofolit dhe bashkëpunon me ta rreth përmbajtjes së tij. Në fillim të periudhës, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, përcaktojnë detyrat dhe punimet që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës.
- Këto detyra zhvillohen gjatë periudhës dhe nuk janë pjesë e vlerësimit të vazhduar (në evidencë), por vetëm pjesë e portofolit lëndor.
- Pjesë e portofolit është edhe projekti kurrikular. Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë vetëm brenda një periudhe, por mund të jetë i shtrirë edhe përgjatë gjithë vitit.

- Sido që të jetë shtrirja e projektit ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.
- Për vlerësimin e portofolit, mësuesi përcakton kritere të qarta dhe ua komunikon nxënësve. Vlerësimi i detyrave të portofolit varet nga pesha që secili mësues i vendos secilës detyrë.
- Rubrikat e portofolit mund të grupohen në:
 - punë dhe detyra të kryera në klasë dhe jashtë saj, si punë praktike, punë laborator, ese, detyrë me shkrim etj;
 - projekte individuale ose në grup;
 - detyra dhe kontribute të pavarura të nxënësit, të cilat janë dëshmi e talentit, e hulumtimeve praktike, e punëve tematike (me shkrim, audio-vizuale etj.).
- Vlerësimi i portofolit mund të planifikohet në planifikimin e periudhave si orë e veçantë ose mund të realizohet përgjatë tre - katër orëve të fundit të periudhës. Në këtë rast mësuesi përcakton një grafik të nxënësve të cilëve do t'u vlerësohet portofoli.

Shembull i vlerësimit të portofolit të lëndës së matematikës:

Në lëndën e matematikës, mësuesi mund të planifikojë 3-4 detyra për portofolin lëndor. Në shembullin më poshtë, mësuesi, në bashkëpunim me nxënësit, ka përcaktuar 4 detyra për portofolin e periudhës së parë, i cili do të ketë gjithsej 50 pikë. Për vlerësimin e portofolit mësuesi **përcakton vetë** pikët/peshat për secilën detyrë. (Më poshtë është dhënë thjesht një shembull, pikët/peshat e të cilit shërbejnë për të ilustruar modelin dhe mund të mos përdoren domosdoshmërisht nga mësuesi).

- Hulumtim mbi përdorimin e algjebërës në jetën reale apo në fusha të tjera të shkencës ose Krijimi i një formule algjebrike që lidh disa madhësi të caktuara etj. (10 pikë)
- Krijimi i një mozaiku duke përdorur shumëkëndëshat ose Hulumtim mbi përdorimin e shumëkëndëshave në arkitekturë etj.(10 pikë)
- Projekti (faza e parë) – Plani i një biznesi – punë grupi.(20 pikë)
- Krijimi i një situatë praktike me përdorimin e TVSH (taksa mbi vlerën e shtuar) ose Krijimi i një situatë praktike me përdorimin e interesit bankar etj. (10 pikë)

Vlerësimi me pikë

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Detyra 4	Portofoli
Nota	7 pikë	10 pikë	17 pikë	8 pikë	42 pikë

Sipas tabelës së vlerësimit me notë (si rasti i testeve), vlerësimi i këtij portofoli është nota 9 (nëntë).

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	>13	13-18	19-24	25 - 31	32-38	39-44	45-50

Vlerësimi periodik

Vlerësimi periodik bëhet në përfundim çdo periudhe dhe përmban tri nota:

- *Vlerësimin e vazhdueshëm* – NV_v , e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Vlerësimin me test ose detyrë përmbledhëse* – NT_p , e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit. (Moduli dhe disa lëndë specifike si Arte, Ed. Fizik etj. mund të jenë me detyrë përmbledhëse).
- *Vlerësimin e portofolit lëndor* – NV_p , e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.

Vlerësimi përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar shënohet në regjistër duke plotësuar kollonat e “Vlerësimit Vjetor” dhe në kollonën e “Notës përfundimtare”.

- Vlerësimet vjetore përmbajnë:
 - *Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar* që është rezultat i tri periudhave.
 - *Notën vjetore të vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse* që është rezultat i tri periudhave.
 - *Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit* që është rezultat i tri periudhave.

Në rast kur ecuria e nxënësit është e dukshme progresive ose regresive gjatë dy periudhave të fundit, vlerësimi i tij vjetor në secilën nga rubrikat mund të jetë progresiv ose regresiv. Në rast kur ecuria e tij nuk është e qëndrueshme përgjatë tri periudhave, atëherë vlerësimi llogaritet me mesatare.

- **Nota përfundimtare** llogaritet me përqindje për secilën nga rubrikat

Tabela: Pësha në përqindje e llojeve të vlerësimit

Lloji i vlerësimit	Pësha në përqindje
Vlerësimi i vazhdueshëm	40%
Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse	40%
Vlerësimi i portofolit të nxënësit	20%

- Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:
 - Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NV_v), bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
 - Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmbledhëse (NT_p) bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
 - Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NV_p) bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
 - Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
 - Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (psh. $8,8 \approx 9$).

$$(NV_V \times 0.4) + (NT_P \times 0.4) + (NV_P \times 0.2) = \text{Nota përfundimtare}$$

- **Përshkrimi i notës përfundimtare vjetore argumenton nivelin e arritjeve të kompetencave të fushës/lëndës. Përshkrimi i referohet pikave më të forta që ka nxënësi lidhur me përmbushjen e kompetencave të lëndës**

Shembull 1: Lënda Matematikë

Periudha I			Periudha II			Periudha III			Vlerësimet vjetore			Nota përfundimtare
NV _V	NT _P	NV _P	NV _V	NT _P	NV _P	NV _V	NT _P	NV _P	NV _V	NT _P	NV _P	
7	8	9	9	8	10	9	9	10	9	8	10	9

$$(9 \times 0.4) + (8 \times 0.4) + (10 \times 0.2) = 8.8$$

Nota përfundimtare 9

Nota përfundimtare	Përshkrimi i vlerësimit
9	<i>Arba (nxënësja) modelon dhe zgjidh situata problemore që lidhen me shumëkëndëshat dhe shënërimet gjeometrike duke përdorur simbolet përkatëse. Ajo përdor rregulla elementare të logjikës e të arsyetimit që lidhen më së shumti me probabilitetin dhe përpunimin e të dhënave duke përdorur programin Word.</i>

Shembull 2: Lënda Matematikë

Periudha I			Periudha II			Periudha III			Vlerësimet vjetore			Nota përfundimtare
NV _V	NT _P	NV _P	NV _V	NT _P	NV _P	NV _V	NT _P	NV _P	NV _V	NT _P	NV _P	
7	6	8	7	7	9	8	6	8	7	6	8	7

$$(7 \times 0.4) + (6 \times 0.4) + (8 \times 0.2) = 6.8$$

Nota përfundimtare 7

Nota përfundimtare	Përshkrimi i vlerëimit
7	<i>Albani (nxënësi) interpreton situata problemore, të thjeshta me veprimet me numra, përqindje dhe fuqi, por paraqet vështirësi në modelimin dhe zgjidhjen e tyre. Ai njih dhe përdor pjesërisht simbolet trigonometrike dhe gjeometrike për të përshkruar situata praktike nga jeta reale.</i>

Shembull 3: Lënda Gjeografi

Periudha I			Periudha II			Periudha III			Vlerësimet vjetore			Nota përfundimtare
NV _V	NT _P	NV _P	NV _V	NT _P	NV _P	NV _V	NT _P	NV _P	NV _V	NT _P	NV _P	
8	7	8	7	7	8	8	7	8	8	7	8	8

$$(8 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (8 \times 0.2) = 7.6$$

Nota përfundimtare 8

Nota përfundimtare	Përshkrimi i vlerësimit
8	Auroni (<i>nxënësi</i>) shpjegon shpërndarjen hapësinore të dukurive fizike gjeografike në shkallë të ndryshme. Komunikon idetë dhe informacionin gjeografik në lidhje me to, me shkrim dhe me gojë, duke përdorur në disa raste fjalor të përshtatshëm gjeografik.

Shembull 4: Lënda Fizikë

Tremujori I			Tremujori II			Tremujori III			Notat vjetore			Nota përfundimtare
NV V	NT _P P	NV P	NV V	NT _P P	NV P	NV V	NT _P P	NV P	NV V	NT _P P	NV P	9
7	6	10	9	8	9	9	8	10	9	8	10	

$$(9 \times 0.4) + (8 \times 0.4) + (10 \times 0.2) = 8.8$$

Nota përfundimtare 9

Nota përfundimtare	Përshkrimi i vlerësimit
9	Nxënësi/ja analizon saktë konceptet, parimet dhe ligjet e mekanikës, ruajtjes së energjisë dhe termodinamikës, duke i ilustruar me shembuj nga situata të jetës reale, por bën ndonjëherë gabime të vogla nga nxitimi. Përdor me efikasitet të lartë njësitë matëse të madhësive fizike, pajisjet dhe teknologjinë për interpretimin e këtyre ligjeve, duke përdorur me lehtësi terminologjinë dhe gjuhën shkencore gjatë interpretimit të tyre.

Vlerësimi i nxënësit për zhvillimin e kompetencave kyçe

- Vlerësimi i nxënësit për kompetencat kyçe bazohet në rezultatet e të nxënësit të kompetencave kyçe për shkallën përkatëse.
- Vlerësimi i nxënësit për kompetencat kyçe realizohet nga mësuesi kujdestar në bashkëpunim me mësuesit e të gjitha lëndëve.

Shembull: Vlerësimi i kompetencave kyçe

Nxënësi/ja	<i>Vlerësimi i nxënësit për realizimin e kompetencave kyçe:</i>
1. Ambra.....	Nxënësja merr pjesë aktive në situatat problemore që diskutohen në orën e mësimit, duke argumentuar në mënyrë krijuese idetë e saj. Është e gatshme për të kontribuar në mënyrë produktive në aktivitetet që organizon shkolla. Ndërton marrëdhënie të shëndetshme me mësuesit dhe shoqërinë e klasës dhe merr pjesë aktive gjatë punëve në grup. Zotëron kompetenca të larta të përdorimit të teknologjisë dhe dallohet në punën me projektet.

	<i>Vlerësimi i nxënësit për realizimin e kompetencave kyçe:</i>
2. Andi.....	Nxënësi demonstroi kureshtje dhe interesim të lartë në të gjitha lëndët. Jep ide të reja gjatë orës mësimore dhe është i gatshëm për të marrë përsipër detyrat që i ngarkohen. Shpreh aftësitë e të menduarit kritik për zgjidhjen e problemeve dhe është i aftë në marrjen e vendimeve. Është i përgjegjshëm për kryerjen e detyrave, por jo gjithmonë është në gjendje të kryejë ato me efikasitet të lartë në mënyrë të pavarur. Bën përpjekje sistematike për t'ju përgjigjur sfidave.

SHTOJCË 1: Modulet kurrikulare me zgjedhje të karakterit të përgjithshëm dhe profesional

Nr.	Modulet lëndore	Orë mësimore
1.	Edukimi financiar	36 orë
2.	Edukimi për karrierë	36 orë
3.	Ndryshimet klimaterike	36 orë
4.	Trashëgimia kulturore	36 orë
5.	Edukimi shëndetësor, aftësim për jetën dhe edukim seksual	36 orë
6.	Pronësia intelektuale	36 orë
7.	Të folurit publik	36 orë
8.	Markat dhe patentat	36 orë

Modulet profesionale		Orë mësimore
1. Fusha e Industrisë së Turizmit dhe mikpritjes		
a)	Guida turistike	36 orë
b)	Etika e të ushqyerit dhe shërbimi në bar-restorant	36 orë
2. Fusha e shërbimeve elektro-shtëpiake		
	Punime të montimit të pajisjeve të shtëpisë	36 orë
3. Fusha e mekanikës		
	Punime të riparimit dhe mirëmbajtjes mekanike	36 orë
4. Fusha e arredimit dhe stilit		
	Etika e të veshurit dhe arredimit	36 orë
5. Fusha e parukerisë dhe estetikës		
	Estetika dhe truku	36 orë
6. Fusha e teknologjisë ushqimore		
	Përpunim i produkteve ushqimore	36 orë
7. Fusha e bujqësisë dhe Veprimtaritë bujqësore dhe ndikimet e saj në jetën e përditshme		
	Kopshtaria	36 orë
8. Fusha e veterinarisë		
	Kujdesi për kafshët e shoqërimin	36 orë
9. Fusha e laboratorit		
	Veprimtari për asistent laboratorit	36 orë
10. Fusha e sekretarisë		
a)	Veprimtari për asistent zyre	36 orë
11. Fusha e kujdesit për klientin		
a)	Veprimtari për shërbimin e klientit	36 orë

SHTOJCË 2: Formate planifikimi**Plani mësimor vjetor - Klasa X****Fusha:****Lënda:**

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës		
	Shtator – Dhjetor	Janar – Mars	Prill – Qershor
<i>Këtu vendosen orët e planifikuara për secilën tematikë për klasën e X, të marra nga programi i shkallës</i>	Orët <i>Në këtë kollonë vendoset përmbajtja e lëndës që do të zhvillohet në këtë periudhë për secilën tematikë</i>	Orët <i>Në këtë kollonë vendoset përmbajtja e lëndës që do të zhvillohet në këtë periudhë për secilën tematikë</i>	Orët..... <i>Në këtë kollonë vendoset përmbajtja e lëndës që do të zhvillohet në këtë periudhë për secilën tematikë</i>

Planifikimi sipas periudhave

Fusha:

Lënda:

<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p align="center">.....</p> <p align="center"><i>Këtu vendosen rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore</i></p>						
<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p align="center">.....</p> <p align="center"><i>Këtu vendosen rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore</i></p>						
Nr.	Tematika (orë)	Temat mësimore	Situatë e parashikuar të të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
		<i>Këtu vendosen temat mësimore për çdo orë mësimi</i>	<i>Këtu vendosen situata të nxënësi që mësuesi parashikon të realizojë gjatë një ose disa temave mësimore)</i>	<i>Këtu vendoset metodologjia e mësimeve që do të përdoret gjatë zhvillimit të këtyre temave (jo shumë e detajuar sepse vendoset në planifikimin ditor)</i>	<i>Këtu vendosen teknikat e vlerësimit të arritjeve të nxënësit (jo shumë e detajuar sepse vendoset në planifikimin ditor)</i>	<i>Këtu vendosen burimet që përdor mësuesi dhe nxënësi për arritjen e rezultateve të nxënies. (jo shumë e detajuar sepse vendoset në planifikimin ditor)</i>

Planifikimi i orës mësimore

Tema mësimore:	Situata e të nxënit:
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:	Fjalët kyçe:
Burimet:	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura etj.	
Vlerësimi: <i>Pjesë e vlerësimit është edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gatë kësaj ore mësimi duke pasur parasysh të dhënat e mbledhura në evidenca e progresit të tij.</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur: <i>Detyrat dhe puna e pavarur të planifikohen në mënyrë të tillë që të mos rrisin ngarkesën e nxënësit. Mundësisht sipas rastit të jenë të integruara brenda fushës apo ndërmjet fushave.</i>	

SHTOJCË 3: Modele evidencash

29.07.2015 Evidence per vleresimin - Word

FILE HOME INSERT DESIGN PAGE LAYOUT REFERENCES MAILINGS REVIEW VIEW MathType Foit PDF Sign in

Clipboard Paste Cut Copy Format Painter Font Paragraph Styles

Calibri (Body) 11 A A Font Paragraph Styles

Normal No Spac... Heading 1 Heading 2 Title Subtitle Subtle Em... Emphasis Intense E... Strong Quote

EVIDENCA TREMUJORE PER MBAJTJEN E VLERESIMEVE TE NXENENSVE

KLASA X- TREMUJORI

Nr	Emri Mbiemër	Muajt/Data:	Komente
1			
2			
3			
4			
5			

Shënim: Ky format llogaritet në A3, si rrjedhim numri i nxënësve është më i madh. Në lëndë mund të ketë një ose dy fletë (nëq të divia foaet). Në varësi të lëndës mund të llogaritet edhe numri i vlerësimeve.

PAGE 1 OF 2 63 WORDS ENGLISH (UNITED KINGDOM)

10:53 28/09/2016

UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E KURRIKULËS SË RE TË GJIMNAZIT

Evidenca formati 2 09.09.2016 - Excel

EVIDENCA TREMUJORE PER MBAJTJEN E VLERESIMEVE TE NXENENSVE										KLASA																					
Nr.	Nxenesi / Data	KOMENTE								Nr.	Nxenesi / Data	KOMENTE								Nr.	Nxenesi / Data	KOMENTE									
1	Abeta Kushi									10										19										28	
2										11										20										29	
3										12										21										30	
4										13										22										31	
5										14										23										32	

Sheet1 Sheet2 Sheet3

READY 10:54 28/09/2016 80%